



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER AIDA E. SHAMETI
ADRESA NR.9, ASIM VOKSHI, NR.36
TEL: 692169784

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

Nr. repertori: 1272

Tirane më 18/06/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



V2021051030064793869



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 18. 06. 2021 para meje **Notere AIDA E. SHAMETI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, ASIM VOKSHI, NR.36, u paraqit personalisht:

1. **NËNSHKRUES: Shoqëria "ALB BUILDING" Shpk**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS J69102508C, me seli në adresë Njesia Bashkiake Nr.9, Rruga Asim Vokshi, Ndertesa Nr.14, Hyrja 4, Apartamenti 6, Kodi Postar 1016, **Përfaqësuar Nga Administratori Odhise Bresha**, atësia Nuredin, amësia Pajainë, shtetas Shqiptar, lindur në Nivice, Tepelenë dhe banues në Tiranë, me adresë S. Delvina Ish Ptt 8112; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 07/12/1965, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032869341 dhe nr. personal G51207084I. **Përfaqësuar Nga Administratori Pëllumb Beta**, atësia Halil, amësia Hysnie, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, me adresë Sulejman Delvina; Nd. Nr.8; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 22/08/1959, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036626475 dhe nr. personal F90822117K.
2. **NËNSHKRUES: Shoqëria "AFT" Sh.a**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L21627015I, me seli në adresë Rruga Ymer Kurti, Pallati Tekno Projekt Nr.9, Njesia Bashkiake Nr.5, Zp 1019, **përfaqësuar nga Romina Ylli**, atësia Arben, amësia Lindita, shtetase Shqiptare, lindur në Lushnjë, Lushnjë dhe banues në Tiranë, me adresë Sulejman Delvina Pall Moskat; Nd. 1831; H. 0; Ap. 022; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë 5; 0000; Tiranë, lindur më 17/08/1988, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033218615 dhe nr. personal I85817061B.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, dokumentin bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

NOTER

AIDA E. SHAMETI

Fq. 1

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR ALB - BM SHPK

KREU I Dispozita te Përgjithshme

Neni 1

- 1.1 Shoqëria "ALB-BM" sh.p.k. themelohet ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe Ligjin Nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (te ndryshuar).

KREU II Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia

Neni 2

Emri dhe Ortaket

- 2.1 Shoqëria është e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" dhe mban emrin "ALB-BM" sh.p.k.
- 2.2 Ortaket e shoqërisë janë
- Shoqëria "ALB BUILDING" sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar me vendim Gjykates se Tiranes nr 6415 date 22.091994, me NIPT J 69102508 C me seli ne Tirane , Shqiperi.
 - Shoqëria "AFT" sh.a., person juridik shqiptar, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, date 27/04/2012 , me NIPT L 21627015I , me seli ne Tirane, Shqiperi.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
- Financimi, Projektimi, Ndertimi, Venia ne Shfrytezim, Operimi, Administrimi, Mirëmbajtja e nje Impjanti per perpunimin e materialeve Bio Mase dhe prodhimin prej tyre produkte te gatshme per nevoja te prodhimit te energjise termike. Tregëtimi i produkteve te prodhuara nga materialet Bio Mase per nevoja te tregut te energjise teroike, si edhe eksportimi i ketyre produkteve sipas nevojave te tregut.Importimi i materialeve Bio Mas dhe nenprodukteve te nevojshshme per zhvillimin e aktivitetit.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një afat të pa caktuar.

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Autostrada Rrogzhinë Lushnie km 12 .
- 5.2 Gjate veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përkatës.

KREU II

Neni 6

Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

- 6.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100,000 (njqind mijë leke) Leka, i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale 50,000 (pesedhjetë mijë) lek secila.
- 6.2 Pjesëmarrja e Ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:


Nr.	Emri i Ortakëve	Kuota	Vlera	Përqindja
1.	ALB BUILDING shpk	1	50,000 lek	50%
2.	AFI sha	1	50,000 lek	50%
3.				
Totali			100 000 lek	100%

6.3 Kuotat e Kapitalit janë të nënshkruara dhe të shlyera plotësisht nga ortakët.

Neni 7

Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

7.1 Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 (katërmbëdhjetë) Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me kështu të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhtëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.



- 7.2 Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.
- 7.3 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën. Perllogaritja e kamatëvonesave do të bëhet sipas ligjit në fuqi.
- 7.4 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojë paraprakisht të paktën 14 (katëmbëdhjetë) Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.
- 7.5 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
- 7.6 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratori konsideron të përshtatshme.
- 7.7 Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuota por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Neni 8

Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

- 8.1 Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

Neni 9

Pronesia dhe Certifikatat e kuotave

- 9.1 Pronesia mbi kuotat do të regjistrohet në regjistrin e ortakëve që do të mbahet në selinë e Shoqërisë nën përgjegjësinë e Administratorit të saj ("Regjistri i Ortakëve").
- 9.2 Regjistri i Ortakëve do të pasqyrojë informacionin e mëposhtëm: (i) identitetin e çdo Ortaku; (ii) numrin e kuotave që i perkasin çdo Ortaku; (iii) vlerën nominale



te kuotave; (iv) daten e fitimit te pronesisë mbi kuotat nga cdo Ortak; (v) adresen apo seline e cdo Ortaku; (vi) detaje per cdo peng apo barre mbi kuotat.

- 9.3 Ortaket kane te drejte, nepermjet paraqitjes se nje kerkese me shkrim, te kerkojne nje ekstrakt te Regjistrimit te Ortakeve, me vulen e Shoqerise.
- 9.4 Ortaket kane te drejte te verifikojne regjistrimin e tyre ne Regjistrimin e Ortakeve dhe Administratori, nese i kerkohet me shkrim, do t'u jape Ortakeve ndihmen e nevojshme per kete qellim.
- 9.5 Te gjitha transferimet e kuotave do te behen ne perputhje me legjislacionin shqiptar te zbatueshem dhe kete Statut dhe do te regjistrohen ne Regjistrimin e Ortakeve.
- 9.6 Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certifikate per kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Në asnjë rast Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 10

Kalimi me Kontratë i Kuotave

- 10.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në seline e shoqërisë.
- 10.2 Administratori mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rrethana të tjera të cilat e bëjnë të pamundur këtë regjistrim.
- 10.3 Nëse Administratori refuzon të regjistrojë kalimin e kuotës, ata do të njoftojnë Asamblenë e Ortakeve brenda një afati 5 ditor nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.
- 10.4 Kalimi i te drejtave, venia peng, barre apo cdo mjet tjetër sigurimi mbi kuotat do të kerkoje - në mënyrë që të prodhojë efekt - miratimin paraprak të Asamblese së Përgjithshme - e cila do të marrë vendim me shumicë të cilesuar.
- 10.5 Nëse një Ortak ka për qëllim të shesë apo transferojë në cdo formë të gjitha apo një pjesë të kuotave të tij një personi të ndryshëm nga Ortaket, Ortaket e tjera kanë të drejtën e parablertjes mbi të gjitha apo një numër të Kuotave të Ofruara. Kjo e drejtë parablertjeje mund të ushtrohet vetëm në përputhje me procedurën e mëposhtme të përcaktuar në nenet 10.6 deri në 10.8.
- 10.6 Nëse një Ortak ka për qëllim të shesë apo transferojë të gjitha apo një pjesë të kuotave të tij ("Kuotat e Ofruara"), ai - përpara se të nënshkruajë marrëveshje me persona të ndryshëm nga Ortaket - do të njoftojë me shkrim Administratorin, për


shitjen apo transferimin e planifikuar, ku te percaktoje gjithashtu edhe cmimin e shitjes/transferimit.

- 10.7 Administratori brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar - do te informoje me shkrim Ortaket e tjere.
- 10.8 Ortaket e tjere qe kane te drejten e parablerjes sipas nenit 10.5 - brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratorit per shitjen apo transferimin e planifikuar - do te njoftojne me shkrim Administratorin nese kane qellim te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes. Administratori - brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi - duhet te njoftoje Ortakun qe ka per qellim te shese/transferoje kuotat e tij.
- 10.9 Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga Ortaket sipas nenit 10.8 me siper, Ortaku qe ka per qellim te shese/transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'ia shese/transferoje keto kuota nje pale te trete.
- 10.10 Nese Ortaku qe ka per qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes ka dhene njoftim, ky Ortak do te kete te drejte te bleje Kuotat e Ofruara - pjeserisht apo teresisht, sic percaktohet ne njoftimin e tij - brenda 30 diteve nga data e dorezimit te njoftimit te tij tek Administratori. Ne rast blerjeje te pjesshme te Kuotave te Ofruara - ne cdo rast ne perputhje me numrin e percaktuar ne njoftimin e derguar nga Ortaku bleres - pjesa e mbetur e Kuotave te Ofruara mund t'i ofrohet dhe te transferohet tek cdo pale e trete me nje cmim shitjeje/transferimi jo me te ulet sesa ai i percaktuar ne njoftimin e permendur ne nenin 10.6
- 10.11 Cdo shitje apo transferim kuotash qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe nuk ka efekte ligjore per Shoqerine.

Neni 11

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 11.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 11.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortakut, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfines të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.



- 11.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

Neni 12

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- 12.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Neni 13

Blerja e Kuotave të Veta

- 13.1 Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

Kreu III

Asambleja e Përgjithshme

Neni 14

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Përgjithshme

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë, por pa u kufizuar, për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:
- percaktimi i politikave tregtare;
 - ndryshime të Statutit;
 - emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel të autorizuar;
 - miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
 - mbikeqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ccurinë e aktivitetit të Shoqërisë;

- g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
- h. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- i. pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjyqime dhe në procedime të tjera kundër administratorit/administratoreve të saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;
- m. miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n. çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti.

14.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përmendura në pikat (g) dhe (h) me sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës.

14.3 Administratori thërret Asamblesë të Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit, do të procedojë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

14.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thërret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilët zotërojnë jo më pak se nëntëdhjetë për qind të vlerës nominale të kuotave.

14.5 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, informacion mbi vendin dhe mënyrën e marrjes së dokumenteve dhe të projekt-vendimeve që duhet t'u vihen në dispozicion dhe do t'u dërgohen të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.

Në rast ndryshimi të rendit të ditës, do të ndiqet e njëjta procedure njoftimi që përshkruhet me sipër.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, Asambleja mbledhet perseri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

14.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

14.7 Në kushtet kur Ortaket kanë kuota të barabarta nga 50% secili, për të gjitha rastet kur për vendimmarrje Asambleja nuk ka dakortesi mbas tre votimeve radhazi, atëherë do të pranohet mekanizimi i shortit për opsionet e secilit Ortak në prani të një noteri publik. Mbas hedhjes së shortit Ortaket bien dakort dhe Asambleja zbardh vendimin në përputhje me rezultatin e marrë nga shortit.

7

Neni 15


Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- 15.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 dhe 87 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 15.2 Administratori cakton Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- 15.3 Administratori, pavarësisht nëse nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
- 15.4 Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- 15.5 Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, Kryetari deklaron nëse vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 15.6 Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet edhe një votim tjetër në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 16

Votat e Ortakëve

- 16.1 Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- 16.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.



- 16.3 Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 17

Votimi me Prokurë

- 17.1 Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas një akti (noterial ose të thjeshtë) sipas një forme të përcaktuar dhe miratuar nga Administratori. Çdo ortak nepermejt përfaqësuesit të tij mund të zgjedhë të votojë "PRO", "KUNDER" ose "ABSTENIM".
- 17.2 Çakimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- 17.3 Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) të shoqërisë, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 18

Hetimet e posaçme

- 18.1 Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nepermejt depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Kreu IV Administratori

Neni 19

Emërimi i Administratorit

- 19.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

19.2 Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

19.3 Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i shoqërisë:

(emer, mbiemer, adresa, etj)

Neni 20


Kompetencat e Administratorit

20.1 Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

20.2 Administratori mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

20.3 Pa u kufizuar sa me sipër, në mënyrë të veçantë Administratori ka këto kompetenca:

- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përse i përket administrimit të zakonshëm;
- (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë, e cila individualisht nuk kalon kufirin prej 5,000,000 (pesemilion) Leke, me përjashtim të marrëveshjeve të parashikuara nga pika (v) këtu;
- (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj, do të përgatisë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipoteke, peng apo çdo marrëveshje tjetër që krijon apo mund të krijojë një barri mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë, deri në kufirin 5,000,000 Leke) secila, me përjashtim të rastit kur autorizohet ndryshe shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të cilesuar;
- (iv) do të urdhërojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave - deri në shumën 5,000,000 Leke secila; me përjashtim të rastit kur autorizohet ndryshe shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të cilesuar;
- (v) do të veprojë me autorizim të posacem të Asamblesë së Përgjithshme për nënshkrimin e çdo marrëveshjeje dhe kryerjen e çdo transaksioni, që individualisht kalon kufirin prej 5,000,000 (pese milione Leke) secili; me për-



- jashtëm të rastit kur autorizohet ndryshe shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblese së Përgjithshme të marre me shumicë të cilesuar;
- (vi) do të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
 - (vii) do të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblese së Përgjithshme;
 - (viii) do të krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershem për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
 - (ix) do të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
 - (x) do të raportojë Asamblese së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - (xi) do të marrë në punë, emerojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për çdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjente, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, do të përcaktojë shpërblimin e tyre, në çdo rast duke mos kaluar vlerën 100,000 Lëke/në vit për secilin prej të emëruarve të mesipër; me përjashtim të rastit kur autorizohet ndryshe shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblese së Përgjithshme të marre me shumicë të cilesuar;
 - (xii) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në çdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhëna me Vendim të Asamblese së Përgjithshme.

Neni 21

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

21.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.
4. shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve për shkelje të legjisllacionit ose paaftesi në përmbushjen e detyrës.

Neni 22

Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

22.1 Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.

22.2 Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë

1

ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënie e përfitimeve të tilla.

- 22.3 Administratori mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme apo mbledhje të tjera në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 23

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 23.1 Administratori nuk do të lidhi marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 23.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.


Kreu V

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 25

Dividendët

- 25.1 Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 25.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emtohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 25.3 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesin ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.



Neni 26

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

- 26.1 Administratorit, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 27

Prishja dhe likuidimi

- 27.1 Shoqëria priset dhe kalon ne procedura likuidimi nese:
1. perfundon afati i kohezgjatjes se Shoqërisë;
 2. merret nje vendim i posacem i Asamblese se Përgjithshme;
 3. kalohet ne falimentim;
 4. Shoqëria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR;
 5. ekziston nje vendim gjykate;
 6. per arsye te tjera te parashikuara ne kete Statut.
- 27.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 27.3 Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKR, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në kete rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKR-se.

Neni 28

Njoftimet

- 28.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 28.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka

disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

- 28.3 Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

Neni 29

Te Ndryshme

- 29.1 Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.
- 29.2 Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punes dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 29.3 Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 29.4 Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilët i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 29.5 Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 29.6 Ky statut firmoset nga palet sot në datë 18.06.2021
- 29.7 Në këtë statut:
1. "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
 2. "Statuti" është Statuti i shoqërisë;
 3. "Ditë të Plota" në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve Themelues:

- Alb Building shpk

Odhise Bresha

Pellumb Beta

-AFT sba

Romina Ylli

Romina Ylli

